



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22.4.2023

Nr: 397

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**PËRCAKTIMIN E SASISË SË FONDIT NGA BUXHETI I SHTETIT QË DO T'U SHPËRNDARHET SI
PARADHËNIE PARTIVE PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE, TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “k”, “n”, e 2, nenit 65, pika 3, neneve 86, 88 dhe 180, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 3, datë 22.4.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Partisë Politike që përfiton fonde nga buxheti i shtetit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, si dhe vendimit nr. 30/2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e fondit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023”,

VËREJ:

Neni 86, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se burimet e financimit të fushatës për subjektet zgjedhore janë edhe fondet e dhëna paradhënie nga buxheti i shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore.

Neni 88, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, parashikon se partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe që kanë marrë jo më pak se 1 për qind të votave në shkallë vendi në zgjedhjet më të afërta pararendëse të të njëjtit lloj, përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, në bazë të numrit të votave që secila parti ka marrë në ato zgjedhje. Fondi për këtë qëllim përcaktohet me vendim të Kuvendit dhe përbën zë më vete në Buxhetin e Shtetit për vitin zgjedhor përkatës. Ky fond nuk mund të jetë më pak sesa totali i shumave të shpërndara partive politike në zgjedhjet pararendëse.

Data: 22.4.2023 Nr: 397
Ora: 12:00



“Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t’u shpërndahet si paradhënie partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.

Neni 180 i Kodit Zgjedhor, “Dispozitë tranzitore për financimin nga buxheti”, përcakton se për zgjedhjet e para të përgjithshme pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, përllogaritja e shpërndarjes së fondeve paradhënie do të bëhen në bazë të rezultatit të zgjedhjeve në shkallë vendi për zgjedhjet vendore 2015 dhe për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017.

Duke qenë se zgjedhjet e para të përgjithshme për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, janë zgjedhjet e datës 14 maj 2023, përllogaritja e numrit të votave të vlefshme bëhet duke marrë numrin më të lartë të votave për secilën parti politike që ka përfituar mbi 1% të votave të vlefshme në njërin nga këto zgjedhje 2015 dhe 2017. Gjithashtu në përllogaritje përfshihen edhe partitë politike që nuk kanë marrë pjesë në njërin nga këto zgjedhje por kanë marrë pjesë në zgjedhjet e vitit 2019 dhe kanë përfituar mbi 1% të votave të vlefshme.

Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve u regjistruan 44 (dyzetë e katër) parti politike , si më poshtë vijon.

1. Partia Demokracia Sociale (PDS);
2. Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë (ADK);
3. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve (PMDE);
4. Partia e Gjelbër (P.GJ);
5. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar (PBD);
6. Partia Ora e Shqipërisë (P.O.SH);
7. Partia Kombëtare Konservatore Albania (PKKA);
8. Partia Demokristiane e Shqipërisë (PDK);
9. Aleanca Arbnore Kombëtare (AAK);
10. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë (P.M.D.P.SH);
11. Partia Emigracionit Shqiptar (P.E.Sh);
12. Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH);
13. Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen (MEGA);
14. Partia Republikane Shqiptare (PR);
15. Partia Unitetit Kombëtar (PUK);
16. Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (P.D.I.U);
17. Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane (ABDE);
18. Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë (P.A.A);

19. Lëvizja Punëtore Shqiptare (P.L.P.SH);
20. Nisma Thurje (NTH);
21. Partia Lëvizja e Legalitetit (PLL);
22. Partia Konservatore (KONS);
23. Balli Kombëtar Demokrat (PBKD);
24. Partia Socialdemokrate (PSD);
25. Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë (PKDSH);
26. Partia e Lirisë (PL);
27. Lëvizja e RE (LRE);
28. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ);
29. Bindja Demokratike (BD);
30. Partia Socialiste e Shqipërisë (PS);
31. Partia Balli Kombëtar (P.B.K);
32. Lidhja Demokristiane Shqiptare (L.D.K);
33. Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë (AD);
34. Partia "Aleanca Progresiste L.ZH.K";
35. Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian (A.M.I.E);
36. Ardhmëria Shqiptare (PASH);
37. Bashkimi Liberal Demokrat (BLD);
38. Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet (ADS);
39. Fryma e Re Demokratike (FRD);
40. Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë (PEISH);
41. Fronti i Majtë (FM);
42. Partia e Reformave Demokratike Shqiptare (P.R.D.Sh);
43. Lëvizja Bashkë (BASHKE);
44. Partia Demokratike (PDSH).

6 (gjashtë) parti politike nga lista e mësipërme kanë formuar dhe janë regjistruar si 2 (dy) koalicione zgjedhore, përkatësisht:

1. Koalicioni "Aleanca Liberale e Djathtë" me shkronjat nistore "ALD", i përbërë nga Partia

Data: 22.4.2023 Nr: 397
Ora: 12:00



"Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t'u shpërndahet si paradhënie partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023".

Balli Kombëtar Demokrat, Partia Bashkimi Liberal Demokrat dhe Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar.

2. Koalicioni “BASHKË FITOJMË” me shkronjat nistore “BF”, i përbërë nga Partia e Lirisë (PL), Partia Demokristiane e Shqipërisë (PDK) dhe Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ).

Referuar vendimeve të KQZ-së nr. 965, datë 10.08.2015, “Për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015”, nr. 555, datë 26.07.2017, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017”, si dhe nr. 1097, datë 27.07.2019, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019”, partitë politike që kanë përfituar jo më pak se 1 për qind të votave në zgjedhjet e viteve 2015, 2017 dhe 2019 janë si më poshtë vijon:

Nr.	Sigla	Rezultati sipas vendimit të KQZ-së		Rezultati sipas vendimit të KQZ-së		Rezultati sipas vendimit të KQZ-së	
		2015		2017		2019	
		Vota të vlefshme	Përqindja e fituar	Vota të vlefshme	Përqindja e fituar	Vota të vlefshme	Përqindja e fituar
1	PD	317,620	20.33%	456,413	28.85%		
2	PR	53,784	3.44%				
3	LZHK	19,644	1.26%				
4	PS	402,709	25.78%	764,750	48.34%	564,679	74.11%
5	PL	259,934	16.69%	225,901	14.28%		
6	PDIU	59,701	3.82%	76,069	4.81%		
7	FRD	29,984	1.92%			8,630	1.13%
8	PDK	20,271	1.30%				
9	PDS	20,064	1,28%			27,865	3.66%
10	PSD	22,320	1.43%			27,422	3.60%
11	BD					20,350	2.67%
12	P.GJ					14,246	1.87%
13	ADK					8,016	1.05%
14	AAK					9,513	1.25%
15	PUK					10,045	1.32%

Në bazë të përllogaritjes mbi numrin më të lartë të votave që partia politike ka marrë në njërin nga këto zgjedhje, partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet e datës 14 maj 2023 që përfitojnë fonde paradhënie të akorduar nga buxheti i shtetit janë si më poshtë:

Nr.	Sigla	Numri më i lartë i votave të vlefshme	Përqindja e fituar	Vlera e përllogaritur / lekë
1	PD	456,413	28.85%	25,563,584.24
2	PR	53,784	3.44%	3,012,429.13
3	LZHK	19,644	1.26%	1,100,255.80
4	PS	764,750	48.34%	42,833,466.73
5	PL	259,934	16.69%	14,558,841.90
6	PDIU	76,069	4.81%	4,260,606.71
7	FRD	29,984	1.92%	1,679,369.75
8	PDK	20,271	1.30%	1,135,373.92
9	PDS	20,064	1.28%	1,123,779.90
10	PSD	22,320	1.43%	1,250,137.92
11	Bindja Demokratike	20,350	2.67%	1,139,798.69
12	P.GJ	14,246	1.87%	797,915.09
13	ADK	8,016	1.05%	448,974.27
14	AAK	9,513	1.25%	532,820.88
15	PUK	10,045	1.32%	562,618.08
	TOTAL	1,785,403		100,000,000

Neni 65, pika 3, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se në momentin e regjistrimit koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ligji përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit.

Koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka dorëzuar në KQZ shkresën nr. 2256/2 prot., datë 4.4.2023 ku sqaron se të gjitha të drejtat dhe detyrimet që Kodi Zgjedhor përcakton do të përmbushen dhe përfitohen nga

partia udhëheqëse e koalicionit, që në rastin konkret për koalicionit “Bashkë Fitojmë” është “Partia e Lirisë”.

Partitë politike që përfitojnë fonde nga buxheti i shtetit dhe janë pjesë e koalicioneve të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023, janë:

1. Partia e Lirisë (Koalicioni “Bashkë Fitojmë”)
2. Partia Demokristiane e Shqipërisë (Koalicioni “Bashkë Fitojmë”).

Referuar nenit 65 Koalicionit “Bashkë Fitojmë” do ti përlllogariten fondet duke mbledhur fondet e përfituara nga 2 (dy) partitë politike pjesë të koalicionit, konkretisht Partia e Lirisë dhe Partia Demokristiane e Shqipërisë.

Fondi i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit me vendimin nr. 30/2023, “Për miratimin e fondit për financimin e partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” është 100,000,000 (njëqind milion) lekë.

Për sa më sipër përlllogaritet, numri i votave të vlefshme nga partitë që janë regjistruar për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të 14 maj 2023, i cili rezulton 1.785,403 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tre).

Vlera në lekë e një vote llogaritet duke pjesëtuar totalin e shumës së vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, 100.000.000 (njëqind milion) lekë me votat e vlefshme, 1.785,403 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tre). Rezultati pas pjesëtimit përcakton vlerën në para të një vote që është e barabartë me 56,0097636 (pesëdhjetë e gjashtë pikë zero zero nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

Referuar pikës 3 të nenit 88, KOZ-ja përlllogarit shumën që i takon secilës parti duke shumëzuar vlerën në para të një vote të vlefshme, e cila është 56,0097636 (pesëdhjetë e gjashtë pikë zero zero nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, me numrin me të lartë të votave të vlefshme që ka marrë secila parti në njërin nga këto zgjedhje.

Neni 180, pika 2 përcakton se partitë të cilat përfitojnë fonde nga buxheti i shtetit janë edhe ato parti politike që nuk kanë marrë pjesë në zgjedhjet 2015 dhe 2017 por kanë marrë pjesë vetëm në zgjedhjet e vitit 2019. Për këtë arsye edhe pse PDS dhe PSD kanë marrë numrin më të lartë të votave në zgjedhjet e vitit 2019, ato përjashtohen nga llogaritja për këtë vit duke qenë se kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e vitit 2015.

Për sa më sipër shuma totale që përfiton secila parti politike e regjistruar për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023, si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore është numri me i lartë i votave të vlefshme që partia politike ka përfituar shumëzuar me vlerën në para të një vote dhe duke i zbritur sanksionet administrative me gjobë vendosur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, përkatësisht:

- për subjektin zgjedhor “Partia Demokratike”, e cila përfiton si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, të datës 14 maj 2023, fondin prej 25,563,54.24 (njëzetë e pesë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëdhjetë e katër pikë njëzetë e katër) lekë do ti zbritet gjoba në vlerë 600,000 (gjashtëqind mijë) lekë e vendosur me vendimin nr. 7, datë 25.01.2023, i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, si rrjedhojë

- subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” do të përfitojë shumën prej 24,963,584.24 (njëzetë e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër pikë njëzetë e katër) lekë;
- për subjektin zgjedhor “Bindja Demokratike”, e cila përfiton si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, të datës 14 maj 2023, fondin prej 1,139,798.69 (një milion e njëqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë gjashtëdhjetë e nëntë) lekë do ti zbritet gjoba në vlerë 500,000 (pesëqind mijë) lekë e vendosur me vendimin nr. 7, datë 25.01.2023, i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, si rrjedhojë subjekti zgjedhor “Partia Bindja Demokratike” do të përfitojë shumën prej 639,798.69 (gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë gjashtëdhjetë e nëntë) lekë;
 - për subjektin zgjedhor “Partia Demokratiane e Shqipërisë”, e cila përfiton si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, të datës 14 maj 2023, fondin prej 1,135,373.92 (një milion e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e dy) lekë do ti zbritet gjoba në vlerë 100.000 (njëqind mijë) lekë e vendosur me vendimin nr. 7, datë 25.01.2023, i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, si rrjedhojë subjekti zgjedhor “Partia Demokratiane e Shqipërisë” do të përfitojë shumën prej 1,035,373.92 (një milion e tridhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e dy) lekë. Subjekti zgjedhor “Partia Demokratiane e Shqipërisë” është pjesë e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, të cilët me shkresën nr. 2256/2 prot., datë 4.4.2023, sqarojnë se të gjitha të drejtat dhe detyrimet që Kodi Zgjedhor përcakton do të përmbushen dhe përfitohen nga partia udhëheqëse e koalicionit, që në rastin konkret për koalicionit “Bashkë Fitojmë” është “Partia e Lirisë”. Pra fondi prej 1,035,373.92 (një milion e tridhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e dy) lekë si rrjedhojë do ti kalojë “Partisë së Lirisë”;
 - për subjektin zgjedhor “Partia SocialDemokrate”, e cila përfiton si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, të datës 14 maj 2023, fondin prej 1,250,137.92 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e dy) lekë ndërkohë që vlera që do ti mbahet këtij subjekti referuar vendimeve të KQZ është 2,129,360 (dy milion e njëqind e njëzetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë si rrjedhojë fondi në vlerën prej 1,250,137.92 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e dy) lekë do ti mbahet subjektin zgjedhor nga shpërndarja e fondeve për fushatën zgjedhore, të datës 14 maj 2023, duke e përjashtuar nga përfitimi i fondeve për fushatë. Subjekti zgjedhor “Partia SocialDemokrate” vazhdon të jetë debitor në vlerën prej 879,222.08 (tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e njëzetë e dy pikë zero tetë) lekë;
 - për subjektin zgjedhor “Partia Fryma e Re Demokratike”, e cila përfiton si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, të datës 14 Maj 2023, fondin prej 1,679,396.75 (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë do ti mbahet kthimi i fondit në vlerën 485,332 (katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë i vendosur me vendimin nr. 224, datë 7.12.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si rrjedhojë subjekti zgjedhor

- “Partia Fryma e Re Demokratike” do të përfitojë shumën prej 1,194,064.75 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë e katër pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë;
- subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfiton si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, të datës 14 Maj 2023, fondin prej 42,833,466.73 (dyzetë e dy milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e tre) lekë;
 - subjekti zgjedhor “Partia Republikane”, përfiton si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, të datës 14 Maj 2023, fondin prej 3,012,429.13 (tre milion e dymbëdhjetë mijë e katërqind e njëzetë e nëntë pikë trembëdhjetë) lekë;
 - subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK”, përfiton si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, të datës 14 Maj 2023, fondin prej 1,100,255.80 (një milion e njëqind mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë) lekë;
 - subjekti zgjedhor “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”, përfiton si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, të datës 14 Maj 2023, fondin prej 4,260,606.71 (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtë pikë shtatëdhjetë e një) lekë;
 - subjekti zgjedhor “Partia Demokracia Sociale”, përfiton si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, të datës 14 Maj 2023, fondin prej 1,123,779.90 (një milion e njëqind e njëzetë e tre mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë) lekë;
 - subjekti zgjedhor “Partia e Lirisë”, si parti udhëheqëse e koalicionit “Bashkë Fitojmë” përfiton si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, të datës 14 Maj 2023, fondin prej 15,594,215.8 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë pikë tetë) lekë fond ky i përbërë nga shuma prej 14,558,841.90 (katërmëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dyzetë e një pikë nëntëdhjetë) lekë fondi që përfiton “Partia e Lirisë” me fondin prej 1,035,373.92 (një milion e tridhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e dy) lekë që përfiton “Partia Demokristiane e Shqipërisë”;
 - subjekti zgjedhor “Partia e Gjelbër”, përfiton si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, të datës 14 Maj 2023, fondin prej 797,915.09 (shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë pikë zero nëntë) lekë;
 - subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, përfiton si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, të datës 14 Maj 2023, fondin prej 448,974.27 (katërqind e dyzetë e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër pikë njëzetë e shtatë) lekë;
 - subjekti zgjedhor “Aleanca Arbnore Kombëtare”, përfiton si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, të datës 14 Maj 2023, fondin prej 532,820.88 (pesëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzetë pikë tetëdhjetë e tetë) lekë;
 - subjekti zgjedhor “Partia Uniteti Kombëtar”, përfiton si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, të datës 14 Maj 2023, fondin prej 562,618.08 (pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë pikë zero tetë) lekë.

Me poshtë tabela përmbledhëse e përlogaritjes së fondeve që do të përfitojë secili subjekt zgjedhor:

Nr.	Partitë Politike	Vota të vlefshme	Vlera e një vote	Totali për çdo parti (lekë)	Vlera e mbajtur nga sanksionet	Totali në lekë për tu shpërndarë
1	PD	456.413	56.0097636	25,563,584.24	600.000	24.963.584.24
2	PR	53.784	56.0097636	3,012,429.13		3,012,429.13
3	Aleanca Progresiste LZHK	19.644	56.0097636	1,100,255.80		1,100,255.80
4	PS	764.750	56.0097636	42.833,466.73		42.833,466.73
5	PL (Koalicioni Bashkë Fitojmë PL-PDK-PBDNJ)	280.205	56.0097636	15,694,215.8	100.000	15,594,215.8
6	PDIU	76.069	56.0097636	4,260,606.71		4,260,606.71
7	FRD	29.984	56.0097636	1,679,396.75	485.332	1,194,064.75
8	PDS	20.064	56.0097636	1,123,779.90		1,123,779.90
9	PSD	27.422	56.0097636	1,250,137.92	2.129.360	0
10	BD	20.350	56.0097636	1,139,798.69	500.000	639,798.69
11	P.GJ	14.246	56.0097636	797,915.09		797,915.09
12	ADK	8.016	56.0097636	448,974.27		448,974.27
13	AAK	9.513	56.0097636	532,820.88		532,820.88
14	PUK	10.045	56.0097636	562,618.08		562,618.08
	TOTAL	1.785.403	56.0097636	100.000.000		97,064,530.08

Neni 88, pika 6, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se fondi i përcaktuar për t’u shpërndarë sipas këtij neni i jepet secilës

Data: 22.4.2023 Nr: 397
Ora: 12:00



“Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t’u shpërndahet si paradhënie partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.

parti jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga regjistrimi i listave shumemërore ose kandidatëve për kryetar të njësive të qeverisjes vendore të partisë përkatëse. Partia politike që përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit dhe KQZ-ja, para shpërndarjes së fondit, nënshkruajnë aktmarrëveshje, në të cilën përcaktohet se partia politike pranon fondin e dhënë, se do ta përdorë atë në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, pranon monitorimin e shpenzimit të tyre prej subjektit dhe kandidatëve të tij, si dhe do të respektojë të gjitha ndalimet që përcaktohen në këtë ligj për ta.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “k”, “n”, e 2, nenit 65, pika 3, neneve 86, 88 dhe 180, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 3, datë 22.4.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Partisë Politike që përfiton fonde nga buxheti i shtetit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Të shpërndajë si paradhënie, fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Nr.	Emri i Partisë Politike	Fondi që përfitohet (lekë)
1	Partia Demokratike (PD)	24.963.584.24
2	Partia Republikane (PR)	3,012,429.13
3	Partia Aleanca Progresiste L.ZH.K	1,100,255.80
4	Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)	42.833,466.73
5	Partia e Lirisë (PL)	15,594,215.8
6	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU)	4,260,606.71
7	Partia Fryma e Re Demokratike (FRD)	1,194,064.75
8	Partia Demokracia Sociale (PDS)	1,123,779.90
9	Partia Socialdemokrate (PSD)	0
10	Bindja Demokratike (BD)	639,798.69
11	Partia e Gjelbër (P.GJ)	797,915.09
12	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë (ADK)	448,974.27
13	Aleanca Arbnore Kombëtare (AAK)	532,820.88
14	Partia Uniteti Kombëtar (PUK)	562,618.08
TOTALI		97,064,530.08